



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

## **KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**

**Nr. 02-060/01-0049042-1/24 dt. 31.07.2024**

**Mitrovicë**

### **P R O C E S V E R B A L** **Nga mbledhja e 33-të e rregullt e Kuvendit të Komunës**

**Koha:** 31.07.2024 ora 10:00

**Vendi:** Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

**Të pranishëm:** Anëtarët e Kuvendit: Vesa Broja, Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Xhafer Preteni, Florina Çitaku, Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Fisnik Krasniqi, Egzon Hamza, Lavdim Zeneli, Nafije Rexha, Faruk Mujka, Naser Muja, Hysen Muzliukaj, Armend Begu, Ekrem Sadiku, Xhevrije Bahtiri Ademi, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Gazmend Asllani, Muhammed Hoti, Oltion Ahmeti, Jeton Ujkani, Vesel Neziri, Gjergj Beka dhe Ardita Aliu

**Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza**

**Nënkyetari i Komunës z. Arian Tahiri**

**Drejtoriët e Drejtoreve**

**Përfaqësues të Shoqërisë Civile**

**Mediat**

**Mungoi:** Mentor Vinarci, Hamdi Hasani, Shkurta Shoshollı Musa, Elidiana Budini Haziri, Jeton Zeneli, Xhylljeta Imeri, Flutura Beka Kamberaj dhe Sevdaim Uka

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja Kuvendit znj. Vesa Broja, e cila fillmisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, mediat dhe të pranishmit tjerë. Kryesuesja Kuvendit në vazhdim theksoi se zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës ka thirrur mbledhjen e 33-të të rregullt të Kuvendit të Komunës me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Në vazhdim Kryesuesja theksoi se me e-mail si material shëthesë iu ka ardhur edhe Raporti për konkurret dhe procesin e zgjedhjes së drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve të shkollave në Komunën e Mitrovicës, i cili propozohet të hyjë në rend dite si pikë e 9-të, përgjigjet e Drejtorisë së Arsimit në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit, si dhe Draft-Plani lokal i veprimit për barazi gjinore 2024-2026 i plotësuar me fjalën përshëndetëse të Kryetarit.

Hap diskutimin për rend të ditës.

Fisnik Suma: Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje për gjithë! Propozoj që ne, si kuvend i komunës së Mitrovicës t'i drejtohem me një kërkesë Qeverisë së Kosovës që kërkesat e minatorëve t'i realizon dhe pagat t'i ekzekuton menjëherë, për shkak se e dimë që qe dy muaj ata minatorë kanë mbetë pa paga. Ata bukën e gojës e sigurojnë nga ajo nëntokë. Minatorët, janë bijtë tanë, janë krenari kombëtare dhe mendoj që duhet të trajtohen me respekt të gjithë, posaçërisht nga Qeveria.

Xhafer Preteni: I nderuari Kryetar, nënkyetar, Sekretari e nderuar, të nderuar drejtori, kolegë asamblistë. Këto ditë komuna e Mitrovicës humbi dy veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Naser Fekë Shosholli dhe Zenel Jashar Hyseni dhe ish-policin, aktivistin, aktorin Rushit Smajli. I propozoj Kuvendit që në respekt për veprimtarinë, jetën e tyre, të bëjmë një minutë heshtje.

Një minutë heshtje (lavdi).

Faruk Mujka: E nderuara Kryesuese, i nderuar Kryetar, Nënkyetar, Ekzekutiv, kolegë dhe gjithë të pranishëm. Paraprakisht, duke e lexuar procesverbalin e mbledhjes së kaluar shihet qartë që Kryesia e Kuvendit, edhe Kryetari ka marrë dy obligime për këtë seancë, m'i sjell dy raporte mendoj goxha të rëndësishme. E para, herën e kaluar u pajtuar edhe Kryetari, kemi kërkuar raport për investimet kapitale, respektivisht përrugët që sot po punohen, siç janë: rruga e Shipolit, rruga "Mbrethesha Teutë", rruga "Ali Zeneli", rruga "Lah Nimani" e që akoma nuk po dimë a kanë përfunduar, kur përfundojnë, a kanë pranime teknike a nuk kanë, a janë paguar a nuk janë paguar, aq më tepër kur drejtori Tmava publikisht reagon pas largimit të asfaltit në rrugën "Lah Nimani", se ka marrë vendim për këtë punë. Po kërkojmë që ky vendim t'i bashkëngjitet këtij raporti, sepse arsyetimet kanë qenë kontraverze derisa drejtori thojke për shkak të kualitetit, e me këqyr kualitetin ai ka qenë shumë më i mirë se ky tjetri te Palestra, ndërsa në anën tjetër operatori thojke kena hypë mbi nivel, domethënë ka qenë gabim projekti, sido që të jetë vendimi i drejtorit e tregon cila është e drejta, dhe e dyta, po ashtu gjatë mbledhjes së kaluar kemi kërkuar që të na prezantohet Raporti i përfituesve të kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga vërvshimet e janarit të vitit 2023, pra ku shihen qartë emrat dhe mbiemrat edhe shuma që kanë përfituar ata në emër të dëmtimit. Tash fatkeqësisht, ne nuk jemi të gatshëm të vazhdojmë seancën pa këto raporte, sepse tekefundit kanë qenë zotimet e juaja dhe së paku respektoni zotimet e juaja. Ne jemi të gatshëm t'i presim ato sot dhe ma merr mendja që keni kohë për me i pru, po jo edhe për me vazhduar seancën. Në ndërkohë, po ashtu, po kërkoj nga ju që, në mungesë të promovimit të projekteve tuaja të hartuara, të realizuara nga komuna e që tregon raporti financiar, ku keni realizuar vetëm shtatëmbëdhjetë për qind të investimeve kapitale, mos i përvetësoni meritat të cilat nuk janë të ekzekutivit siç është Qendra e Kulturës dhe të tjera. Po thoni që po injoroheni nga Qeveria e projektet e tyre pi heshtni, e dini që vetëm në emër të eficiencës së energjisë ka përfituar komuna dy pikë tre milionë euro, kemi edhe projekte të tjera. Tash ne këtu në Kuvend, jemi edhe për me kërkuar përgjegjësi, e jo veç me ju aplauduar vendimeve dhe pikave, skenareve, të cilat ju shkojnë përshtati edhe juve. Po kërkojmë që të diskutohen edhe për pikat që kanë interes edhe për neve. Për shembull, drejtoresha e ka ofruar një raport, me gjithë respektin, atij veç raport nuk i thuhet. Kush u pranuar dhe me çfarë date është pranuar, e dimë edhe prej faqeve. Tash për mos me hi më thellë, në qoftë se disa drejtorë që kanë qenë edhe drejtorë të Arsimit, edhe drejtorë të shkollave shpallet konkursi për drejtor, pse po i leni ushtrues detyre, ushtruesi detyre ka kompetenca të njëjtë si drejtor. Nëse nuk është i astë me qenë drejtor, nuk duhet me qenë as ushtrues detyre. Sido që të jetë, ju lus, kryesuese, me na tregu a ka mundësi mu sjell këto dy raporte sot ose jo. Nëse jo, ne shihemi në seancën e radhës.

Kryetari Bedri Hamza: Përshëndetje për anëtarët e asamblesë, ekzekutiv, gjithë ju të pranishëm. E drejta e qëndrimit apo jo në seancë të një asamblisti apo te një grupi të asamblistëve unë mendoj që është në diskrecion të tyre. Megjithatë votat i kemi kërkuar për me nejtë në seancë

edhe me dhënë kontributin tonë. Nëse flasim për zotime, sigurisht se formulimi ka qenë ose në një nga seancat e ardhshme ose në seancën e ardhshme, që nëse doni, pasi që sot nuk janë raportet e mbajmë një seancë shumë shpejt dhe i sjellim ato raporte. Unë po kërkoj që me qenë raportet, kush kanë qenë përfitues të përkrahjes me ka dy mijë e pesëqind euro, dihen, pagesat janë kryer përmes llogarisë, edhe po kërkoj, edhe po e urdhërojë drejtorinë kompetente, në këtë rast përvèç drejtorisë kompetente edhe Drejtorinë e Financave, që në mbledhjen, po e precizoj që në mbledhjen e parë që mbahet, kurdo që mbahet, me qenë raporti me listën e përfituesve, raporti i detajuar me emër, me mbiemër, me shumë, me datë. Tutje, sa i përket projekteve si fondi për eficiencën e energjisë elektrike, është financim i komunës së Mitrovicës, për shkak se Komuna e Mitrovicës ka me i paguar paret. Sa i përket Raportit të DA-së, procesi ka qenë i rregullt, janë respektuar të gjitha procedurat. Kushdo që konsideron që iu ka shkelë e drejta, e inkurajoj edhe e lus me e ndjekë rrugën e vet ligjore. Është jashtëzakonisht pozitiv fakti se rreth tetëdhjetë për qind apo mbi tetëdhjetë për qind e shkollave janë me drejtorë, e kemi gjetur pjesën dërrmuese të tyre pa drejtor, po flasim për dhjetëra-dhjetëra shkolla pa drejtor, edhe është jashtëzakonisht inkurajues edhe pozitiv fakti që në një konkurrencë të hapur ligjore, më së shumti janë vendos gra të suksesshme në fushën e arsimit dhe për këtë jam i lumtur. Te çështja e asfaltit, ju kam thënë dhe po e deklaroj publikisht, edhe kërkoj që në çdo rast, në çdo moment, kur konstatohet, kur ka ndonjë element që ka nevojë me u korriguar diçka, duhet me ndodhë, por jo me qenë barrë financiare e komunës, jo komuna me paguar pare për mos kryerjen e punëve në përputhje me standardet edhe me ligjin. I lus menaxherët e kontratave, komisionet teknike me e kryer punën në përputhje me ligjin, e kanë fituar kontratën, le t'i kryejnë punët, le t'u përbahen standardeve, le t'i marrin pagesat.

Faruk Mujka: Kuvendi është vend i politikave, kështu që jena të lirë me i shpreh qëndrimet edhe me bë politikë, për këtë punë edhe kemi dalë me lyp votat po edhe me kërkuar përgjegjësi për to qysh kërkohet përgjegjësi prej neve, kërkohet përgjegjësia edhe prej teje. Kur flasim për përfondin e eficiencës së energjisë, kryetar, ju e dini që një pjesë të madhe të tyre e kam nënshkruar edhe vet, kështu që jam në rrjedha komplet qysh paguhet dhe me kënd lidhen ato marrëveshje. Nuk e kemi problem, tek e fundit është për të mirën e qytetarëve. Domethënë raportet nuk vijnë sot, në rregull pra kur të vijnë, ne jemi këtu, se tash është gushti, muaji i pushimeve, shtatori është muaji i buxhetit, nuk jemi këtu me i aplauduar përzgjedhjes drejtorëve. E dyta, ju kisha propozuar ndërkohë kryetar me lidhë marrëveshje pasi nuk po doni me TV Mitrovicën, me dikë tjetër, me i bo këto mbledhje pak më publike mos me mendu njerëzit që po fsnihni apo fshehim diçka.

Kryetari Bedri Hamza: Sa i përket transmetimit dhe incizimit të mbledhjeve unë kam kërkuar me hapë procedurën, me ecë me procedura edhe kush të fiton, le të fiton. Ndërsa sa i përket raporteve mbledhjen e radhës kurdo që të mbahet kena me i sjellë.

Grupi i anëtarëve të LVV-së lëshoi mbledhjen.

Kryesuesja Vesa Broja: Pasi nuk ka të lajmëruar të tjerë për diskutim për rendin e ditës vë në votimin propozimin që pikë e 9) e rendit të ditës të jetë Raporti për konkurset dhe procesin e zgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën e Mitrovicës.

### **Rezultati i votimit 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

Kryesuesja e konstatoi të miratuar propozimin që pikë e 9) e rendit të ditës të jetë Raporti për konkurset dhe procesin e zgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën e Mitrovicës.

Kryesuesja në vazhdim vuri në votim këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

2. Propozim-vendim për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut
3. Draft-Plani lokal i veprimit për barazi gjinore 2024-2026
4. Raporti finansiar për periudhën janar-qershor 2024
5. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2023
  - 5.1 Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023
6. Raport i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. për vitin 2023
7. Raport i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP “Tregu” për vitin 2023
8. Dorëheqja e znj. Edina Sejdiu Hamzagiq nga pozita e anëtares së Komitetit për Komunitete
9. Raporti për konkursen dhe procesin e zgjedhjes së drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve të shkollave në Komunën e Mitrovicës
10. Pyetje dhe përgjigje

**Rezultati i votimit: 19 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Rendi i ditës u miratua unanimisht.**

### **Pika 1**

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua me shumicë votash (18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime).

### **Pika 2**

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut theksoi se për të njëjtën eshtë diskutuar në mbledhjen e kaluar.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

**Rezultati i votimit: 19 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Propozim-vendimin për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut.**

### **Pika 3**

Kryesuesja Vesa Broja hapi diskutimin lidhur me Draft-Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Draft-Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026.

**Rezultati i votimit: 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**  
**Kryesuesja e konstatoi të miratuar Draft-Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026.**

#### **Pika 4**

Kryesuesja Vesa Broja hapi diskutimin lidhur me Raportin financiar për periudhën janar-qershor 2024.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Raportin financiar për periudhën janar-qershor 2024.

**Rezultati i votimit: 19 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**  
**Kryesuesja konstatoi se miratohet unanimisht Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2024.**

#### **Pika 5**

Kryesuesja Vesa Broja hapi diskutimin lidhur me Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2023 dhe Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023.

**Rezultati i votimit: 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**  
**Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023.**

#### **Pikat 6 dhe 7**

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Raportin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. për vitin 2023, përtak arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Kryetares së Komisionit znj. Florina Çitaku.

Pas arsyetimit të pikës nga znj. Florina Çitaku, Kryesuesja Vesa Broja hapi diskutimin.  
Gazmend Asllani: Sa i përket Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. për vitin 2023, kam një pyetje: Në tabelën nr. 2, te pagat e bordit, në vitin 2022 shuma e pagave ka qenë 3,976 €, ndërsa në vitin 2023 shuma e pagave ka qenë 15,220 €, pse ky dallim kaq i madh?

Elvis Feka: Viti 2022 ka qenë viti i rekrutimit të anëtarëve të Bordit të ndërmarrjes, gjatë këtij viti janë zhvilluar procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit, dhe të njëjtit janë paguar në fund të vitit, pra pas zgjedhjes së tyre, ndërsa gjatë vitit 2023 janë kompensuar për tërë vitin, prandaj edhe është ky dallim.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim u vazhdua me pikën tjeter.  
Kryesuesja përtak arsyetuar Raportin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP “Tregu” për vitin 2023 fjalën ia kaloi Kryetarit të Komisionit z. Xhafer Preteni.

Pas arsyetimit të pikës nga z. Xhafer Preteni, Kryesuesja Vesa Broja hapi diskutimin.  
Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim u vazhdua me pikën tjeter.

### **Pika 8**

Kryesuesja Vesa Broja theksoi se me datë 19.04.2024, znj. Edina Sejdiu Hamzagic për arsy personale ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtares së Komitetit për Komunitete. Pas konsultimeve me përfaqësues të komuniteti boshnjak për ta zëvendësuar të njëjtën ka ardhur propozimi që znj. Anesa Collakoviq, anëtare e komunitetit boshnjak ta zëvendësoj znj. Edina Sejdiu Hamzagic në Komitetin për Komunitete, prandaj hapi diskutimin lidhur me këtë pikë.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim dorëheqjen e znj. Edina Sejdiu Hamzagic nga pozita e anëtares së Komitetit për Komunitete dhe zëvendësimin e saj me znj. Anesa Collakoviq nga i njëjti komunitet.

**Rezultati i votimit 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht dorëheqjen e znj. Edina Sejdiu Hamzagic nga pozita e anëtares së Komitetit për Komunitete dhe zëvendësimin e saj me znj. Anesa Collakoviq nga i njëjti komunitet.**

### **Pika 9**

Nuk pati diskutim.

**Mbledhja përfundoi punimet në ora 10:55 min.**

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Merita PRETENI

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

